



**Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Zhvillimit,
Saad Alfarargi**

**Vizitë zyrtare në Shqipëri
15 deri më 24 nëntor 2022**

KONSTATIME DHE REKOMANDIME PARAPRAKE

Tiranë, më 24 nëntor 2022

Konstatime dhe rekomandime paraprake të Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Zhvillimit, z. Saad Alfarargi, në përfundim të vizitës së tij në Shqipëri.

Tiranë, (24 nëntor 2022) – Në përfundim të vizitës së tij në Shqipëri, gjatë së cilës Raportuesi i Posaçëm zhvilloi disa takime në Tiranë, Elbasan dhe Kamëz, z. Saad Alfarargi dha këtë deklaratë:

Dëshiroj të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen time të sinqertë për Qeverinë e Shqipërisë që më ftoi për të zhvilluar një vizitë zyrtare si Raportues i Posaçëm për të Drejtën e Zhvillimit dhe për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre të plotë përpara dhe gjatë qëndrimit tim këtu.

Gjatë vizitës sime zyrtare nga data 15 deri më 24 nëntor 2022, vizitova Tiranën dhe bashkitë e Elbasanit dhe Kamzës dhe pata mundësi të takohem me një numër të madh përfaqësuesish të Qeverisë, organizatave të shoqërisë civile, si dhe me zyrtarë të Kombeve të Bashkuara.

Deklarata për të Drejtën e Zhvillimit është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 4 dhjetor 1986 përmes Rezolutës 41/128 dhe Shqipëria ishte ndër vendet që votuan pro miratimit të saj. Neni 1 i Deklaratës për të Drejtën e Zhvillimit e përkufizon të drejtën për zhvillim si një të drejtë të patjetërsueshme të njeriut, në sajë të së cilës çdo qenie njerëzore dhe të gjithë popujt kanë të drejtë të marrin pjesë, të kontribuojnë dhe të gëzojnë një zhvillim ekonomik, social, kulturor dhe politik, ku të mund të realizohen plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Qysh atëherë, e drejta për zhvillim është riafirmuar në disa marrëveshje ndërkombëtare, si në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin të vitit 1992, në Deklaratën e Vjenës të vitit 1993 dhe në Programin e saj të Veprimit. Së fundmi, në vitin 2015, e drejta për zhvillim është njohur në mënyrë të padiskutueshme në katër dokumente kyçe të politikave të miratuara në nivel ndërkombëtar: në Axhendën për Veprim në Adis Abeba të Konferencës së Tretë Ndërkombëtare për Financimin për Zhvillim; në Kuadrin Sendai për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive 2015-2030; “Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm”, e cila përfshinte Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm; si dhe në Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet Klimatike. Këto dokumente janë bërë pjesë e politikave dhe bazës normative të mandatit tim.

Objektivat e mia gjatë kësaj vizite ishin kryesisht të mësoja më shumë dhe të kuptoja më mirë, duke i parë vetë më sytë e mi, përparimin e bërë lidhur me të drejtën për zhvillim në Shqipëri, si dhe të identifikoj sfidat e ndryshme ekzistuese, me qëllim formulimin e disa rekomandimeve për Qeverinë dhe për aktorët e tjerë që po punojnë për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe për promovimin e realizimit të së drejtës për zhvillim në vend.

Isha veçanërisht i interesuar të mësoja më shumë se si e promovon dhe si e garanton pushteti qendror dhe pushteti vendor pjesëmarrjen efikase të publikut në politikat dhe programet e zhvillimit; me çfarë sfidash kryesore përballet vendi në zbatimin e të drejtës për zhvillim; dhe çfarë politikash dhe masash janë ndërmarrë për të trajtuar pabarazitë, duke përfshirë edhe pabarazitë për shkak të gjinisë, aftësisë së kufizuar, statusit social dhe pabarazitë për shkaqe të tjera. Unë fokusohem te pabarazitë, pasi ato përbëjnë një pengesë kryesore në realizimin e të drejtës për zhvillim. Në fakt, pabarazitë ndikojnë në aftësinë e individëve dhe të komuniteteve për të marrë pjesë, kontribuar dhe gëzuar zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe politik, si dhe kërcënojnë zhvillimin afatgjatë social dhe ekonomik dhe pengojnë uljen e varfërisë.

Zgjedha të zhvilloj një vizitë në Shqipëri sepse besoj se është një vend që ka arritur një progres mbresëlënës, pavarësisht sfidave të shumta me të cilat është përballur.

Pjesëmarrja e grave në zhvillimin politik dhe ekonomik

Për ta nisur pozitivisht, dua të theksoj se Shqipëria ka arritur një progres mbresëlënës në sigurimin dhe institucionalizimin e pjesëmarrjes së grave në organet qeverisëse dhe vendimmarrëse, në pushtetin qendror, në administratën publike dhe është në rrugën e arritjes së një niveli të lartë përfaqësimi të grave në nivelet drejtuese të bizneseve. Sipas informacioneve të marra, nga deputetët e zgjedhur në parlamentin aktual, 92 janë burra (65.7%) dhe 48 janë gra (34.3%); Kryetarja e Kuvendit është grua dhe mbi 70% e ministrave në qeverinë qendrore janë gra. Në vitin 2019, përqindja e grave të punësuar në poste të larta drejtuese në sektorin publik ishte 41,3 %. Këto ndryshime pozitive vijnë kryesisht falë ndryshimeve progresive të legjislacionit zgjedhor.

Duket se gratë janë më pak të përfaqësuara në pushtetin vendor – megjithëse, sipas të dhënave të marra, 44% e mandateve të këshillave vendore në zgjedhjet lokale të vitit 2019 janë fituar nga kandidatet gra, megjithatë, nga gjithsej 61 kryetare bashkie, vetëm tetë janë gra. Përveç kësaj, gratë nga komunitetet e disavantazuara vazhdojnë të jenë të papërfaqësuara si në parlamentin e ri, ashtu edhe në kabinetin e ministrave. Së fundi, duket se nuk ka të dhëna të disponueshme për përqindjen e grave në gjyqësor. Sa i përket buxhetimit, më informuan se në periudhën 2017-2021, ka pasur një rritje të rëndësishme të buxhetimit gjinor, nga 1% e totalit të buxhetit, në 9% në ciklin buxhetor 2022-2024. U inkurajova jashtëzakonisht kur mësova se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka filluar të përdorë treguesit kryesorë të performancës me ndjeshmëri gjinore për monitorimin e ekzekutimit të buxhetit dhe se raportimi për këta tregues do të zbatohet për herë të dytë në vitin 2022. Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit është në procesin e finalizimit të auditimit të parë gjinor, i cili

do të nisë në janar 2023. Pres me kënaqësi të shoh ndikimin e këtyre masave pozitive.

Megjithëse nivelet arsimore të grave dhe burrave duket të jenë përgjithësisht të barabarta, pjesëmarrja e grave në forcën punëtore duket se është më e ulët - sipas statistikave të vitit 2021, në grupmoshën 30-64 vjeç marrin pjesë si forca të punës 86,9% e burrave dhe 68.7% e grave. Për grupmoshën 15-29 vjeç, përqindjet janë 58,6 % për burrat dhe 46,3 % për gratë. Nuk ka të dhëna të ndara për situatën në rajonet rurale, por përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë ngritur shqetësime në lidhje me nivelet shumë më të larta të papunësisë në zonat rurale. Përveç kësaj, gratë duket se punësohen kryesisht në sektorë si shëndetësia dhe shërbimet sociale, arsimi, prodhimi dhe bujqësia, të cilat karakterizohen nga paga më të ulëta. Më tej, nevojat e paplotësuara për kujdesin ndaj fëmijëve çojnë në pasivitetin e grave. Gratë bëjnë 96% të punëve të shtëpisë, kurse 18% e grave nuk punojnë, kryesisht për shkak të punës së papaguar të kujdesit në shtëpi (krahasuar me vetëm 1% burra). Po kështu, vajzat kryejnë pothuajse katër herë më shumë punë të kujdesit të papaguar se djemtë.

Sa i përket sektorit privat, u informova se megjithëse pjesëmarrja e grave në biznes është rritur gjatë dekadës së fundit (25.4% e grave zotërojnë ose drejtojnë një biznes), shumica e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë janë biznese mikro/të vogla, me më pak kapitale sa duhet dhe kryesisht në sektorë informalë dhe me më pak vlerë të shtuar. Pjesëmarrja aktive e grave në zhvillimin e sektorit privat vazhdon të jetë e ulët, veçanërisht për gratë në zonat rurale. Hendeku gjinor në mundësitë për kredi nuk është zvogëluar me kalimin e viteve.

I bëj thirrje Qeverisë të shtojë përpjekjet për të nxitur përfshirjen e barabartë të grave në forcën e punës dhe për t'u fokusuar më shumë në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e zonave rurale. Përveç kësaj, u bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse qendrore dhe lokale të punojnë për sigurimin e një numri të mjaftueshëm vendesh në institucionet e kujdesit për fëmijët, si në çerdhe dhe kopshte, për t'u dhënë mundësi nënave të reja të kthehen në forcën e punës. Më shumë punë duhet bërë për të përmbysur stereotipat gjinore në lidhje me punët e shtëpisë dhe për të pakësuar punën e papaguar të kryer nga gratë.

Dhuna në familje ndikon në aftësinë e viktimave për të gëzuar të drejtën e tyre për zhvillim, për shembull, duke pakësuar aftësitë e tyre për të marrë pjesë në forcën e punës për shkak të lëndimeve ose zhvendosjeve dhe rezulton në barrë financiare shtesë për rrjetet e mbrojtjes sociale. Më erdhi mirë që dëgjova, si nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, ashtu edhe nga zyrtarët shtetërorë dhe bashkiakë, për përparimin e bërë lidhur me rishikimin e legjislacionit dhe politikave për luftën kundër dhunës në familje dhe për bashkëpunimin e mirë që ekziston mes aktorëve që punojnë në këtë fushë. Pavarësisht të gjitha përpjekjeve, ka ende një

numër të madh viktimash të dhunës në familje çdo vit dhe u bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse që ta përqendrojnë më shumë vëmendjen në zbatimin e masave ekzistuese, në përdorimin sistematik të sanksioneve të duhura për mosrespektimin e ligjit dhe në investime për rritjen e kapaciteteve të personave që janë të parët që trajtojnë ankesat për dhunë në familje.

Mekanizmat e llogaridhënies kundër diskriminimit

U informova se, vitet e fundit, janë zhvilluar dhe përmirësuar ndjeshëm kuadri ligjor dhe politikat kundër diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ligji kundër diskriminimit u ndryshua në vitin 2020, duke sjellë një sërë përmirësimesh, përfshirë edhe përfshirjen e disa shkaqeve të reja të diskriminimit, si identiteti gjinor, orientimi seksual, karakteristikat seksuale, HIV/AIDS dhe pamja fizike; kalimi i barrës së provës nga paditësi tek i padituri në të gjitha rastet që lidhen me diskriminimin; përfshirja e formave të reja të manifestimit të diskriminimit, si diskriminimi ndërsektorial, ngacmimi dhe ngacmimi seksual dhe gjuha e urrejtjes. Janë rishikuar edhe Kodi i Punës dhe Kodi i Procedurës Administrative për të ndryshuar barrën e provës në lidhje me diskriminimin në vendin e punës.

Ju përgëzoj për faktin se legjislacioni ofron mundësi për të paraqitur ankesa për shkaqe të ndryshme diskriminimi si pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ashtu edhe pranë gjykatave. Megjithatë, sipas informacioneve të marra, praktika gjyqësore e antidiskriminimit, veçanërisht në sistemin gjyqësor, nuk është zhvilluar ende në mënyrë thelbësore. Inkurajoj shoqërinë civile dhe organizatat që veprojnë në terren që të shfrytëzojnë mekanizmat e disponueshme dhe autoritetet përgjegjëse, si Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë dhe Shkollën e Administratës Publike, për të ofruar trajnime të specializuara shtesë për gjyqtarët dhe prokurorët për zbatimin e legjislacionit të mësipërm në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Rekomandoj gjithashtu të rishikohet Kodi i Procedurës Civile, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin antidiskriminues sa i përket barrës së provës. Përveç kësaj, rekomandoj gjithashtu që institucionet e krijuara për të garantuar barazinë gjinore në kuadër të Ligjit për Barazinë Gjinore të financohen si duhet, në mënyrë që të kenë burimet e nevojshme njerëzore dhe burime të tjera për të zbatuar mandatet e tyre.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile

Roli i organizatave të shoqërisë civile dhe bashkëpunimi i tyre me autoritetet dhe me aktorët e tjerë përkatës është thelbësor për avancimin e të drejtës për zhvillim dhe të të drejtave të njeriut më gjerësisht. Me kënaqësi mësova nga organizatat e shoqërisë civile se ato kanë qenë pjesë e diskutimeve që kanë çuar në hartimin e politikave të brendshme të zhvillimit, legjislacionit dhe buxhetimit. U inkurajova

edhe më shumë kur mësova se pjesëmarrja e shoqërisë civile në proceset e konsultimit që kanë të bëjnë me përpunimin e strategjive dhe të planeve lokale dhe kombëtare të veprimit, si dhe të proceseve të buxhetimit, parashikohet tashmë në disa akte legislative. Inkurajoj të gjitha nivelet e qeverisjes që ta përfshijnë shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë në diskutime të tilla që në fazat e hershme të proceseve, në mënyrë që ato të kenë kohën e duhur për t'i shqyrtuar dhe për të dhënë kontributet e veta për maksimizimin e ndikimit të tyre në punën për politikën dhe legjislacionin e zhvillimit, veçanërisht ato që prekin të drejtat ekonomike dhe sociale të popullsisë.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri, u takova me shumë organizata aktive të shoqërisë civile që punojnë me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit. Megjithatë, u shqetësova kur mësova se procedurat e regjistrimit për krijimin e një organizate joqeveritare janë komplekse dhe të gjata, mjaft të kushtueshme dhe të centralizuara në kryeqytet, duke e bërë më të vështirë regjistrimin e këtyre organizatave për personat që jetojnë në zona të largëta. Ndryshe nga këto organizata, krijimi i një kompanie të re biznesi është thjeshtuar dhe mund të bëhet në distancë dhe online. U bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse të rishikojnë kushtet e krijimit të organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë që t'i bëjnë ato të lehta, të shpejta dhe jo të kushtueshme, veçanërisht për shoqatat e vogla nga zonat e thella dhe rurale, në mënyrë që komunitetet të mund të përfaqësohen më mirë në procese të ndryshme konsultimi.

Situata e personave me aftësi të kufizuara

U takova me disa organizata të personave me aftësi të kufizuara dhe u informova se ata përballen me përjashtim dhe varfëri, si për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të popullatës në përgjithësi, ashtu edhe për shkak të problemeve të përhapura lidhur me mundësitë e qasjes së tyre. Nivelet e pensioneve të aftësisë së kufizuar dhe fondet e ofruara për personat që asistojnë personat me aftësi të kufizuara janë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të tyre. Në të njëjtën kohë, personat me aftësi të kufizuara duket se nuk janë të përfaqësuar sa duhet në organet legislative dhe drejtuese si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor.

Sa u përket mundësive për përdorimin e kujdesit shëndetësor, u informova për pengesat e shumta me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ndërtesat ku ata nuk kanë qasje; mungesën e transportit publik për ta; mosdhënien e informacioneve në formate të përdorshme për personat me aftësi të ndryshme të kufizuara; mungesën e personelit të kualifikuar siç duhet për të adresuar nevojat e tyre specifike, duke përfshirë edhe në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues; si dhe mungesën e pajisjeve të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Gratë me aftësi të kufizuara përballen edhe me pengesa të tjera kur përpiqen të përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues.

Përveç kësaj, duket se nuk ekzistojnë të dhëna të fundit dhe të besueshme për numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe për llojet e aftësisë së kufizuar që i prekin ata.

U informova gjithashtu se shumica e shkollave nuk janë të përshtatura fizikisht për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithëse një numër shkollash të rindërtuara pas tërmetit të vitit 2019 janë përshtatur sipas kritereve të qasjes në to, duhet bërë ende shumë punë për ta bërë të gjithë sistemin shkollor të përdorshëm nga fëmijët me aftësi të kufizuara.

U inkurajova kur dëgjova se numri i mësuesve ndihmës të dedikuar për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla dhe për t'i ndihmuar ata ka arritur në 1600 në të gjithë vendin dhe se së fundmi është futur një program mësuesor i posaçëm në universitet për përgatitjen e mësuesve ndihmës që punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara. U bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse që të marrin masa për punësimin e një numri të mjaftueshëm mësuesish ndihmës, veçanërisht në zonat e thella dhe rurale, dhe për të investuar në edukimin e tyre të vazhduar, në mënyrë që ata të jenë plotësisht të kualifikuar për të plotësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me probleme të shumta që lidhen me infrastrukturën publike në të cilën ata nuk mund të kenë qasje. Rrugët dhe ndërtesat publike nuk mund të përdoren për karriget me rrota; kryqëzimet në rrugë nuk janë të pajisura me semaforë të përshtatur për personat me probleme me shikimin dhe për personat me karrige me rrota; informacionet për një sërë çështjesh nuk janë të disponueshme sa duhet për personat me probleme me shikimin ose dëgjimin, sa për të përmendur vetëm disa nga problemet më urgjente. U inkurajova kur dëgjova se ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara” dhe aktet nënligjore përkatëse janë rishikuar për të përfshirë në to edhe disa sanksione për institucionet publike dhe kompanitë që nuk përmbushin kërkesat e aksesueshmërisë, megjithëse u informova edhe se këto sanksione nuk zbatohen sistematikisht. U bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse që ta shohin me prioritet zbatimin e legjislacionit dhe vendosjen e sanksioneve ndaj aktorëve publikë dhe privatë që nuk respektojnë ligjin.

Më tej u informova se ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” parashikon që punëdhënësit duhet të punësojnë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës. Megjithatë, aktet nënligjore për zbatimin e atij ligji, të cilat do të duhej të përfshinin edhe ngritjen e një mekanizmi për zbatimin e tij, nuk janë miratuar ende. Gjithashtu, nuk ka të dhëna zyrtare, të ndara sipas llojit të aftësisë së kufizuar, lidhur me nivelet e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Sipas

informacioneve të marra, më pak se 200 persona me aftësi të kufizuara janë të punësuar në administratën publike dhe akoma më pak në biznese private.

I bëj thirrje Këshillit të Ministrave që të miratojë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 15/2019, duke përfshirë edhe ngritjen e një mekanizmi të konsoliduar për zbatimin e tij, dhe për ta parë këtë çështje me prioritet. Përveç kësaj, u bëj thirrje autoriteteve të investojnë në mbledhjen e të dhënave të përshtatshme dhe të zbërthyer në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë financimin e duhur për zbatimin e ligjit, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri të mos jenë mes atyre që mbeten pas.

Gjithashtu u informova se mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara janë pezulluar për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-19 dhe nuk kanë rinisur ende. U bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse qeveritare që t'i rifillojnë këto takime dhe të vazhdojnë dialogun me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara dhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile.

Jam në dijeni se Shqipëria do të dorëzojë së shpejti një raport në Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe besoj se kjo është një mundësi e shkëlqyer për t'i diskutuar këto çështje me ekspertët e këtij Komiteti dhe për të ndërmarrë hapa drejt zgjidhjes së problemeve me të cilat ata përballen.

Zhvillimi rural

Më shqetëson edhe fakti që komunitetet e thella dhe rurale po mbeten pas sa i përket zhvillimit, duke çuar në varfëri, papunësi dhe marxhinalizim të personave që jetojnë në këto zona. U inkurajova kur dëgjova se në verën e vitit 2022 është miratuar Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Peshkimit dhe se në këtë strategji parashikohet ofrimi i mbështetjes financiare për fermerët që zotërojnë ose që marrin me qira një sipërfaqe të caktuar toke dhe për peshkatarët, pas një procesi aplikimi që menaxhohet nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural. Megjithatë, jam i shqetësuar se kjo skemë duket se është krijuar për t'u ofruar mbështetje fermave të mesme dhe të mëdha, duke lënë jashtë fermerët e vegjël, të cilët sipas informacionit që kam marrë, përbëjnë 29% të të gjitha fermave në vend. U bëj thirrje autoriteteve përgjegjëse qendrore dhe bashkiake që të marrin masa që nga kjo skemë të përfitojnë edhe fermerët e vegjël dhe të angazhohen në një fushatë të gjerë informimi në lidhje me zbatimin e Strategjisë dhe me procesin e aplikimit, si dhe t'u ofrojnë ndihmë praktike pa pagesë aplikantëve të mundshëm, veçanërisht në zonat e thella rurale ku njerëzit nuk kanë njohuri dhe lehtësi të nevojshme. Gjithashtu, i bëj thirrje Qeverisë dhe donatorëve ndërkombëtarë që të sigurojnë financimin e duhur të kësaj skeme.

Përveç kësaj, ndërkohë që skemat mbështetëse janë të orientuara drejt nxitjes së prodhimit, shqetësimet kryesore të komuniteteve që jetojnë në zona të thella, me

sa u informova, kanë të bëjnë me qasjen në shërbimet publike, si me kujdesin e duhur shëndetësor, arsimimin e fëmijëve të tyre dhe me mbrojtjen sociale të kategorive të cënueshme të komuniteteve. U informova se popullsia rurale ka ardhur duke u pakësuar me ritme alarmante, pasi njerëzit largohen nga zonat rurale për të kërkuar kushte më të mira jetese në qytete dhe jashtë vendit. Për të trajtuar shqetësimet e tyre, strategjitë për zhvillimin e jetës ekonomike duhet të plotësohen edhe me strategji për përmbushjen e të drejtave sociale dhe ekonomike të njerëzve në komunitetet e thella.

Disa nga organizatat me të cilat u takova ngritën shqetësime në lidhje me nivelet e ndryshme të përfshirjes së popullatës urbane dhe rurale dhe shkallën e ulët të mundësive të komunikimit dhe pjesëmarrjes në nivel bashkiak, veçanërisht në zonat e thella rurale. Ulja e numrit të njësive të qeverisjes vendose nga më shumë se 300 në 61, pas reformës administrative të vitit 2015, rezultoi në largimin e shumë komuniteteve nga pushteti vendor dhe në kufizimin e mundësive për pjesëmarrje dhe përfaqësim në proceset e konsultimit dhe planifikimit lokal. Meqenëse popullsia në zonat e thella vuan nga niveli më i lartë i varfërisë dhe përjashtimit, u bëj thirrje njësive të qeverisjes vendore që të shtojnë përpjekjet për përfshirjen e këtyre komuniteteve në vendimmarrje lidhur me çështjet që i prekin ato. I bëj gjithashtu thirrje Qeverisë qendrore të punojë për rritjen e kapaciteteve të qeverive vendore, për ngritjen dhe institucionalizimin e mekanizmave konsultativë pjesëmarrës në lidhje me planifikimin e buxheteve bashkiake dhe të organizatave bazë, për një pjesëmarrje kuptimplotë në këto procese.

Sipas informacionit që kam marrë, gratë janë shumë të përfshira në aktivitete bujqësore që kërkojnë punë intensive: që nga viti 2020, në bujqësi kanë punuar 41.4% e grave dhe 31.8% e burrave. Megjithatë, vetëm 8% e fermave në Shqipëri menaxhohen nga gra. Ky problem duket se rrjedh kryesisht nga tradita, sipas së cilës toka bujqësore trashëgohet nga burrat dhe është në pronësi të burrave, pavarësisht ligjeve të trashëgimisë që parashikojnë të drejta të barabarta për trashëgimtarët burra dhe gra. Për adresimin e këtij problemi, rekomandoj që të përshpejtohet ecuria e garantimit të gëzimit të plotë të të drejtave pronësore nga gratë, duke përfshirë edhe zhvillimin ose ndryshimin e akteve nënligjore dhe të procedurave administrative sipas rastit, si dhe investimin në përpjekje serioze për ndryshimin e stereotipave gjinore në lidhje me pronësinë e tokës në shoqëri.

Konkluzion

Në përgjithësi, vizita ime në Shqipëri ka qenë produktive dhe frytdhënëse. Komentet e mësipërme janë të natyrës paraprake dhe nuk janë gjithëpërfshirëse sa i përket objektit të vizitës. Unë do të përgatis një raport të plotë dhe të detajuar për këtë vizitë dhe një sërë rekomandimesh konkrete me fokus masat që duhet të

ndërmerren, raport që do të prezantohet në sesionin e 54 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në shtator 2023.